



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 394/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha, dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Fushë Kosovë, për shkak të vendosjes së posterit në objekte publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Fushë Kosovë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.10.2013, nga subjekti politik LVV dega në Fushë Kosovë, me të cilën pretendohet se më 29.10.2013 në ora 13:10 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë vërejtur posterin e Partisë Demokratike që ishte ngjitur në shtyllën e ndriçimit rrugor në Rr. Nëna Terezë. Parashtruesi i ankesës thekson se vendi ku është ngjitur posterit është në pronësi publike të komunës, ngjitja e materialit zgjedhor është në kundërshtim me dispozitat ligjore që janë në fuqi dhe posterit i ngjitur është i kandidatit për kryetar dhe anëtarëve të Kuvendit Komunal. Sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e Nenit 33 pika b) të LZP-së, dhe nenit 3.4 pika b të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se posteret e kandidatëve të subjektit politik PDK janë vendosur në pronësi publike, nuk qëndrojnë sepse nuk është ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se ku gjendet shtylla në fjalë dhe se a është në pronësi publike të komunës, me këtë rast vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar dhe nuk mund të vërtetohet shkelja e supozuar. Andaj në kuptim 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur PZAP-i vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 394/2013 më datën 01.11.2013



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*